



**Lotaria
e Kosovës**

RREGULLAT E LOJËS SË FATIT TELEBINGO

Prishtinë, Dhjetor 2016

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 22 të Ligjit për lojërat e fatit nr. 04/L-080, Drejtoria e Lotarisë së Kosovës më 01.12.2016, miratoi

RREGULLAT E LOJËS SË FATIT TELEBINGO

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Këto Rregulla paraqesin kushtet për organizimin e lojës së fatit TeleBingo 15 nga 90, dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e Lotarisë së Kosovës dhe pjesëmarrësve në lojën TeleBingo 15 nga 90.

Neni 2

Loja e fatit TeleBingo 15 nga 90 (në vazhdim: loja Bingo) është lojë me numra, e cila zhvillohet me tërheqjen e numrave përmes aparatit (mikserit) ku me parë përcaktohet lartësia e fondit të fitimit.

Neni 3

Për detyrimet ndaj pjesëmarrësve (në vazhdim: lojtarëve), Lotaria e Kosovës (në vazhdim: organizatori) përgjigjet me të gjitha mjetet që disponon, nëse janë plotësuar kushtet e parapara me këto Rregulla.

Për pagesën e fitimeve në lojën e fatit Bingo garanton Qeveria e Kosovës.

Neni 4

Pagesa për lojën Bingo pranohet në pikat e shitjes të organizatorit përmes terminalit on-line ose duke paguar mbushjen (depozitin) për marrjen e tiketës ndihmëse dhe e-vërtetimin për pagesën përmes faqes së internetit të organizatorit.

Pikat e shitjes sipas këtyre rregullave janë të pajisura me terminale on-line për pranimin e pagesave të cilat janë në lidhje të vazhdueshme me sistemin qendror të organizatorit (në vazhdim: sistemin ON-LINE), përmes të cilit lojtari mundet, me ndihmën e përfaqësuesit të organizatorit të luaj lojën Bingo.

Neni 5

Këto Rregulla janë bazë ligjore dhe juridike për lidhjen e marrëveshjes për pjesëmarrje në lojën e fatit Bingo 15 nga 90.

Në pikat e shitjes marrëveshja sipas paragrafit 1. të këtij neni lidhet në mes të organizatorit dhe lojtarit në bazë të pranimi të kushteve të përgjithshme të përcaktuara me këto Rregulla, sipas vullnetit të lirë të lojtarit të shprehur me aktin e pagesës për pjesëmarrjen në lojë, të shënuar në vërtetimin e lëshuar mbi pagesën.

Për pjesëmarrje në lojën Bingo përmes kanalit të internetit të organizatorit, marrëveshja sipas paragrafit 1. të këtij neni lidhet në mes të organizatorit dhe lojtarit në bazë të pranimi të Rregullave të përgjithshme të pjesëmarrjes përmes internetit, sipas vullnetit të lirë të lojtarit, me zgjedhjen e tiketave ndihmëse të ofruara për lojë dhe e-vërtetimin mbi pagesën në faqen e internetit të organizatorit.

Këto Rregulla (kushtet e përgjithshme) obligojnë palët në marrëveshje, si organizatorin ashtu edhe pjesëmarrësit në lojë.

Neni 6

Vërtetimi në kuptim të këtyre Rregullave konsiderohet vërtetimi mbi pagesën dhe përshkrimi identik i tij në sistemin qendror të organizatorit. Pjesëmarrës në lojën Bingo konsiderohet personi i cili me organizatorin ka lidhur marrëdhënie sipas nenit 5 të këtyre Rregullave, dëshmi e së cilës është posedimi vërtetimit mbi pagesën nëse e ka bërë pagesën në pikën e shitjes të autorizuar ose kur në vërtetimin e tij është shënuar numri identifikues, me kusht që përmbajtja e vërtetimit të jetë regjistruar në diskut e bazë - CD para tërheqjes së numrave të kombinimit fitues si dhe që shënimet kompjuterike në vërtetimin mbi pagesën dhe në CD të jenë identike. Personi fizik më i ri se 18 vjet nuk mund të merr pjesë në lojë. Me qëllim të verifikimit të moshës pjesëmarrësi është i obliguar, me kërkesë të organizatorit të ja jap në shikim dokumentin personal.

Neni 7

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për lojërat e fatit, me Rregullat e lojës përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Lotarisë së Kosovës dhe të pjesëmarrësve në lojën Bingo.

I. Emri dhe selia e organizatorit

Neni 8

Lotaria e Kosovës me seli në Prishtinë, Dardania - Kurrizi 15/17, është organizatore e lojës së fatit Bingo 15 nga 90.

II. Emërtimi, përshkrimi dhe kohëzgjatja e lojës së fatit Bingo

Neni 9

Loja e fatit Bingo 15 nga 90 organizohet sipas xhirove, një herë në javë në kuadër të emisionit televiziv. Në çdo xhiro të lojës Bingo tërhiqen numrat nga grupi i numrave prej 1 deri në 90, deri sa të konstatohet se ekziston së paku një kombinim me 15 numra të qëlluar në përputhje me nenin 28 të këtyre Rregullave. Organizatori ka të drejtën të organizoj edhe xhiro të jashtëzakonshme apo festive të lojës Bingo, për çka pjesëmarrësit i njofton me kohë. Njëkohësisht organizatori e mban të drejtën që gjatë sezonit të verës të bëjë pauzë, dhe për këtë duhet të njoftojë pjesëmarrësit me kohë.

III. Kushtet për pjesëmarrje në lojën e fatit Bingo

Neni 10

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Bingo 15 nga 90 që bëhen në pikat e shitjes të organizatorit, pranohen ekskluzivisht vetëm përmes sistemit on-line me leximin e tiketës ndihmëse.

Neni 11

Në lojën Bingo 15 nga 90 marrin pjesë vetëm kombinimet e numrave të cilët janë shënuara në vërtetimet mbi pagesat dhe vërtetimet elektronike, të paguara përmes internetit.

Nëse ekziston mospërputhje në mes kombinimeve të shënuara në vërtetimin mbi pagesën me ato që janë të shënuara në diskun bazë- CD atëherë vlen shënimi në diskun bazë- CD.

Neni 12

Pranimi i pagesës në pikat e shitjes fillon me leximin e tiketës ndihmëse, dhe përfundon me përshkrimin e përmbajtjes së tij në sistemin qendror të organizatorit, pagesën e shumës të shënuar në vërtetimin mbi pagesën dhe dhënien e vërtetimit lojtarit.

Vërtetimi mbi pagesën

Neni 13

Vërtetimi mbi pagesën merr pjesë në atë xhiro të lojës Bingo 15 nga 90 për të cilën është bërë pagesa, në pajtim me nenin 6 të këtyre Rregullave.

Vërtetimi mbi pagesën i paguar në pikat e shitjes

Neni 14

Vërtetimi mbi pagesën është përshkrim kompjuterik në trakë dhe si i tillë paraqet dëshmi të vetme për pjesëmarrje në lojë. Përshkrimi i vërtetimit mbi pagesën (nga lartë-poshtë):

- Emri i organizatorit- Lotaria e Kosovës,
- Numri identifikues i vërtetimit,
- Teksti: “VERTETIMI I PAGESES”,
- Teksti: “TV BINGO”,
- Numri i xhiros,
- Numri i pagesës 12 shifror,
- Numri serik 12 shifror,
- Teksti: “KOMBINIMET”,
- Përshkrimi i kombinimeve të luajtura: 90 numra të ndryshëm në 6 (gjashtë) kombinime, secili nga 15 numra,
- Teksti: “Shuma” dhe vlera e paguar në Euro,
- Numri i pikës së shitjes, data dhe koha e pagesës,
- Kodi kontrollues 12 shifror (në formë numri dhe bar kodi).

Vërtetimi mbi pagesën mund të përmbaj edhe informata tjera.

Neni 15

Lojtari që luan lojën Bingo 15 nga 90 në pikën e shitjes është i obliguar që menjëherë pas pagesës të verifikoj vërtetimin mbi pagesën. Në të kundërtën reklamacionet e mëvonshme nuk vlejné.

Për pagesën dhe përzgjedhjen e tiketës përmes faqes së internetit të Lotarisë së Kosovës, lojtari duhet të kryej vërtetimin e transaksionit të dëshiruar të tiketës së zgjedhur.

Transaksioni i kryer njëherë i pagesës nuk mund të anulohet.

Vërtetimi mbi pagesën përmes mbushjes në pikat e shitjes dhe përzgjedhja e tiketës përmes faqes së Lotarisë së Kosovës - vërtetimi elektronik (e-vërtetimi)

Neni 16

E- vërtetimi është përshkrimi elektronik i vërtetimit të paguar i cili është në llogarinë virtuale të lojtarit (LK - llogari) në sistemin qendror të organizatorit dhe është e shënuar me numër identifikues të lojtarit.

E-vërtetimi është dëshmi ekskluzive dhe e vetme për pjesëmarrjen në lojë të atyre lojtarëve të cilët luajnë duke zgjedhur tiketën përmes faqes së internetit të organizatorit. E-vërtetimi merr pjesë në atë xhiro të lojës për të cilën shënimi kompjuterik i tij është i shkruar në diskun bazë – CD.

Në e-vërtetimin përveç shënimeve të cilat janë në vërtetim mbi pagesën nga neni 15. gjendet edhe numri identifikues 9 shifror i lojtarit.

Neni 17

Organizatori është i obliguar që shënimet në diskun bazë - CD ti deponoj me kohë në trezorin e organizatorit. Deponimi me kohë i CD-së llogaritet deponimi që bëhet para fillimit të tërheqjes së numrave për xhiron e caktuar të lojës Bingo 15 nga 90.

IV. Territori në të cilin organizohet loja e fatit Bingo

Neni 18

Loja e fatit Bingo 15 nga 90 organizohet në territorin e Republikës së Kosovës.

V. Çmimi i pagesës së tiketës

Neni 19

Çmimi i vërtetimit për pjesëmarrje në lojën e fatit Bingo për një tiketë ndihmëse me 6 kombinime të luajtura në xhirot e rregullta është 1,00 Euro, kurse çmimi i vërtetimit për pjesëmarrje në lojë në xhirot e jashtëzakonshme dhe festive është 1,50 Euro.

VI. Afati i fundit i pagesës për pjesëmarrje në lojën Bingo 15 nga 90

Neni 20

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Bingo pranohen deri në afatin e përcaktuar nga organizatori me vendim të veçantë.

Për afatin e fundit të pranimit të pagesës, organizatori është i obliguar të informoj pjesëmarrësit përmes njoftimit të vendosur në të gjitha pikat e shitjes të autorizuara nga Lotaria e Kosovës.

VII. Shuma totale e paguar për xhiro

Neni 21

Pagesën për një xhiro të lojës Bingo 15 nga 90 e përbën shuma e përgjithshme e pagesave të pranuar në pajtim me shënimet në diskun bazë- CD, të deponuar me kohë në trezorin e organizatorit.

Pagesa nga paragrafi 1 i këtij neni vërtetohet dhe shpallet para fillimit të tërheqjes të kombinimit fitues për xhiron përkatëse të lojës Bingo.

VIII. Lartësia e fondit të fitimit dhe llojet e fitimeve

Neni 22

Fondi i fitimit i një xhiroje përkatëse të lojës Bingo 15 nga 90 përcaktohet prej bazës të cilën e përbën pagesa sipas nenit 21 të këtyre Rregullave.

Fondi i fitimit për një xhiro të lojës Bingo është 50% nga baza sipas paragrafit 1. të këtij neni. Shuma e fondit të fitimit për xhiro duhet të bëhet publike para tërheqjes së numrave.

Neni 23

Fondi i fitimit ndahet në:

- Bingo..... 40%
- Dhjetë të qëlluara në dy rreshta deri në numrin 35 të tërhequr..15%
- Pesë të qëlluara në një rresht deri në numrin 33 të tërhequr.....40%
- Fituesi i parë me dhjetë të qëlluara në dy rreshta..... 3%
- Fituesi i parë me pesë të qëlluara në një rresht 2%

Shuma e secilit lloj të fitimit nga paragrafi 1. përcaktohet ashtu që pjesa e fondit të fitimit i dedikuar për atë lloj fitimi pjesëtohet me numrin e fitimeve të atij lloji.

Neni 24

Në lojën Bingo 15 nga 90 janë këto lloje të fitimeve:

1. Fitimi i llojit të parë – BINGO

Nëse në njërin nga 6 kombinimet e të shënuara në vërtetim qëllohen të gjithë 15 numrat e tërhequr deri atëherë, duke filluar nga numri:

-15 (pesëmbëdhjetë) deri në numrin e 35.(tridhjetepesë) të tërhequr me radhë realizohet fitimi SUPERBINGO. Shuma për SUPERBINGO përbëhet nga fondi i fitimit për SUPERBINGO dhe fondi i fitimit për BINGO nga xhiroja përkatëse.

Nëse nuk ka fitim SUPERBINGO në xhiron përkatëse, fondi i fitimit për SUPERBINGO bartet –akumulohet në fondin e fitimit SUPERBINGO për xhiron e ardhshme.

-36 (tridhjetegjashtë) i tërhequr realizohet fitimi BINGO 36+. Shuma për BINGO 36+ përbëhet nga 50% e fondit të fitimit për BINGO për xhiron përkatëse.

Organizatori mundet me vendim të posaçëm të garantoj shumën më të ulët për fitimin SUPERBINGO si dhe të rris fitimet e ndonjërit nga llojet e fitimeve.

Realizimi i fitimit të llojit të parë në një kombinim e humb të drejtën në realizimin e fitimeve të llojit të dytë dhe të tretë në të njëjtin kombinim.

2. Fitimi i llojit të dytë – DHJETË TË QËLLUARA NË DY RRESHTA

Realizohet deri në numrin e 33.(tridhjetetë) të tërhequr me radhë ose kur realizohet fitimi SUPERBINGO para numrit 33. të tërhequr, nëse janë qëlluar 10 numra në dy nga tre rreshtat të kombinimit të shënuar në vërtetim. Realizimi i fitimit të llojit të dytë në një kombinim e humb të drejtën në realizimin e fitimit të llojit të tretë në të njëjtin kombinim. Nëse në ndonjë xhiro nuk ka fitim me Dhjetë të qëlluara në dy rreshta, fondi i fitimit për këtë kategori bartet në fondin e fitimit të së njëjtës kategori në xhiron e ardhshme.

3. Fitimi i llojit të tretë – PESË TË QËLLUARA NË NJË RRESHT

Realizohet deri në numrin e 33.(tridhjetetë) të tërhequr me radhë ose kur realizohet fitimi SUPERBINGO para numrit 33. të tërhequr, nëse janë qëlluar 5 numra në cilindo rresht të kombinimit të shënuar në vërtetim.

4. Fitimi i llojit të katërt – FITIMI I PARË ME 10 TË QËLLUARA NË DY RRESHTA

Realizohet gjatë tërheqjes kur për herë të parë në një kombinim të paguar qëllohen 10 numra në dy nga tre rreshtat të kombinimit të shënuar në vërtetim. Lojtari nuk e humb të drejtën në pagesën e këtij fitimi nëse në kombinimin e njëjtë realizon fitimin e llojit të parë apo të dytë të fitimit. Në këtë rast shuma e fitimit të llojit të katërt i shtohet ose fitimit të llojit të parë, ose fitimit të llojit të dytë që ka realizuar në atë kombinim.

5. Fitimi i llojit të pestë – FITIMI I PARË ME 5 TË QËLLUAR NË NJË RRESHT

Realizohet gjatë tërheqjes kur për herë të parë në një kombinim të paguar qëllohen 5 numra në cilindo rresht të kombinimit të shënuar në vërtetim. Lojtari nuk e humb të drejtën në pagesën e këtij fitimi nëse në kombinimin e njëjtë realizon fitimin e llojit të parë, llojit të dytë apo llojit të tretë të fitimit.

Shpërblimet tjera

Organizatori ka të drejtë të ndaj edhe shpërblime tjera për mysafir në studio si dhe për lojtarët përmes tërheqjes së kuponave. Kuponi është pjesë e tiketës ndihmëse dhe plotësohet nga vet lojtari me vullnetin e tij të lirë, në të cilët ka shënuar të dhënat e tij (emrin, mbiemrin, nr. e telefonit, vendbanimin).

Me tërheqjen e kuponit, nëse të dhënat janë të shënuara, thirrret lojtari me telefon dhe ai duhet të thotë TeleBingo në mënyrë që të vazhdoj me lojën dhe të zgjedh numrin e zarfit ku është shpërblimi. Këto shpërblime ndahen nga sponsorët dhe nuk prekin fondin e fitimit.

IX. Përshkrimi i tiketës ndihmëse për lojën Bingo

Neni 25

Tiketa ndihmëse TeleBingo përbëhet nga ballina e tiketës dhe pjesa e prapme e sajë. Secila tiketë ndihmëse në pjesën ku ka të bëjë me lojën Bingo 15 nga 90, përmban gjashtë kombinime të ndryshme të numrave si dhe të gjithë numrat prej 1 deri 90 në gjashtë kombinime me nga pesëmbëdhjetë numra. Çdo kombinim përbëhet nga 27 (njëzetë e shtatë) fusha të renditura në tre rreshta të njëjtë, në të cilët janë të shënuara 15 (pesëmbëdhjetë) numra të ndryshëm prej 1 deri në 90, me nga pesë numra në çdo rresht dhe së paku me një numër në secilën prej 9 shtyllave.

Të gjithë numrat e shënuar duhet të jenë prej numrit 1 deri 90.

- në shtyllën e parë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 1 deri 9
- në shtyllën e dytë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 10 deri 19
- në shtyllën e tretë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 20 deri 29
- në shtyllën e katërt të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 30 deri 39
- në shtyllën e pestë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 40 deri 49
- në shtyllën e gjashtë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 50 deri 59
- në shtyllën e shtatë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 60 deri 69
- në shtyllën e tetë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 70 deri 79
- në shtyllën e nëntë të çdo kombinimi duhet të jenë numrat prej 80 deri 90.

Në çdo rresht duhet të jenë ekskluzivisht pesë numra.

Përveç kësaj, në tiketën ndihmëse është shtypur edhe barkodi, numri serik i tiketës, informata për organizatorin dhe kuponi për shënimin e të dhënave të lojtarit. Në pjesën e pasme të tiketës ndihmëse janë të shënuara njoftime dhe udhëzime të shkurta për lojtar, llojet e fitimeve kryesore dhe çmimi për pagesën e tiketës ndihmëse. Në të dy anët e tiketës ndihmëse është e shtypur logoja e Lotarisë së Kosovës.

Neni 26

Në një xhiro të lojës Bingo nuk ka mundësi të lajmërohen dy kombinime me numra të njëjtë- kombinime të njëjta.

X. Mënyra dhe procedura e tërheqjes si dhe verifikimi i fitimeve

Neni 27

Tërheqja e numrave për lojën Bingo 15 nga 90 bëhet përmes transmetimit të drejtpërdrejtë televiziv, në prani të komisionit prej tre anëtarëve, njërin prej të cilëve e cakton Ministria e Financave (Kryetarin e Komisionit) kurse dy të tjerët i cakton organizatori (një përfaqësues i organizatorit dhe një nga ana e lojtarëve).

Tërheqja e numrave realizohet përmes aparatit (mikserit), në të cilin paraprakisht vendosen 90 topa në të cilët janë të shënuar numrat prej 1 deri në numrin 90.

Me teknikën e tërheqjes së numrave përmes aparatit – mikserit, punon operatori i tërheqjes të cilin e cakton organizatori.

Në rast të prishjes-dëmtimit të aparatit për tërheqjen e numrave - mikserit, komisioni vendos për vazhdimin e tërheqjes së numrave me dorë.

Tërheqja me dorë e numrave bëhet nga njëri prej anëtarëve të komisionit të cilit paraprakisht i mbyllet sytë me një pëllhurë, dhe pastaj bënë tërheqjen e topave të pa tërhequr nga aparati i dëmtuar përmes vrimës ekzistuese në aparat, të paraparë për këtë rast.

Numri i tërhequr me dorë i prezantohet komisionit dhe publikut. Numri konsiderohet i tërhequr atëherë kur topi me numër e lëshon hapësirën për përzierje.

Tërheqja e numrave bëhet derisa nuk realizohet fitimi BINGO.

Nëse fitimi SUPERBINGO realizohet nga numri i 15.(pesëmbëdhjetë) i tërhequr deri në numrin e 35.(tridhjetepesë) të tërhequr, tërheqja përfundon dhe vërtetohen fitimet e llojit të parë, dytë , tretë, katërt dhe llojit të pestë.

Nëse fitimi BINGO nuk realizohet me numrin e 35.(tridhjetepesë) të tërhequr, atëherë tërheqja vazhdon deri sa nuk realizohet fitimi i llojit të parë të cilin në këtë rast e quajmë fitimi BINGO 36+.

Fitimet e llojit të dytë dhe të tretë vërtetohen me numrin e 33.(tridhjetetë) të tërhequr, me përjashtim në rastet kur fitimi SUPERBINGO realizohet para të njëjtit.

Në një kombinim të numrave mund të realizohet vetëm njëri nga tri llojet më të mëdha të fitimeve (lloji i parë, i dytë dhe i tretë), dhe fitimi i llojit më të madh e përjashton fitimin më të ulët.

Fitimet e llojit të katërt dhe të pestë i shtohen fitimeve të llojit më të lartë (parë, dytë dhe tretë) të realizuara në një kombinim.

Topi me numër i tërhequr një herë nuk mund të merr pjesë prapë në tërheqje.

Shënimet për shumën e paguar dhe kombinimet që marrin pjesë në lojë për xhiron përkatëse, vendosen dhe ruhen në kompjuter, përmes të cilit përcillet tërheqja e numrave po ashtu në mënyrë kompjuterike konstatohet numri i kombinimeve fituese, llojet e fitimeve dhe lartësia e tyre si dhe vendet në të cilat është bërë pagesa për tiketat fituese.

Neni 28

Gjatë tërheqjes mbahet procesverbali të cilin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit.

Procesverbali duhet të përmbajë vendin, kohën, pagesën e përgjithshme për xhiro, fondin e fitimit , numrat e tërhequr sipas radhës së tërheqjes, llojet e fitimeve dhe shuma e fitimeve.

Vërtetimi i fitimeve

Neni 29

Fitimet gjegjësisht fituesit i zbulon programi kompjuterik kurse i vërteton Komisioni për vërtetimin e fitimeve në përbërje prej tre anëtarëve.

Komisioni është i obliguar që shënimet në procesverbalin për tërheqjen dhe vërtetimin e fitimeve ta deponoj në trezorin e organizatorit në pajtim me nenin 11 të këtyre rregullave. Hapja dhe mbyllja e trezorit bëhet në prezencën e tre anëtarëve të komisionit.

Puna e komisionit rregullohet me udhëzim të veçantë të cilën e përpilon organizatori.

XI. Mënyra e publikimit të shumës së fondit të fitimit dhe rezultatet e lojës

Neni 30

Raporti e fondit të fitimit për një xhiro të lojës Bingo publikohet para fillimit të tërheqjes së numrave për atë xhiro.

Raporti i përkohshëm i rezultateve të lojës për xhiro të lojës Bingo shpallet pas tërheqjes së numrave përmes TV. Raporti për rezultatet e tërheqjes dhe të fitimeve publikohet faqen e internetit të organizatorit dhe në pikat e shitjes.

Raporti përfundimtar i fitimeve

Neni 31

Raporti përfundimtar duhet të përmbajë së paku këto shënime:

- Numri rendor i xhiros dhe data e tërheqjes,
- Rezultatet e tërheqjes,
- Shuma e paguar dhe fondi i fitimit,
- Numri i fitimeve dhe shuma e fitimeve sipas llojeve të fitimeve, numrin e vërtetimeve të fitimeve Super Bingo (kur ka fitues) dhe Bingo,
- Afati i fundit (vjetërsia) për pagesën e fitimeve.

Raporti përfundimtar i fitimeve publikohet në faqen zyrtare të organizatorit më së largu 7 (shtatë) ditë nga dita e tërheqjes.

Raportin përfundimtar e vërteton organizatori.

XII. Mënyra dhe afati i pagesës fitimeve

Mënyra e pagesës së fitimeve

Neni 32

Pagesa e fitimeve të llojit të parë Bingo bëhet në selinë e organizatorit.

Pagesa e fitimeve me 10 të qëlluara - dy rreshta dhe 5 të qëlluara - një rresht, varësisht nga shuma e tyre bëhet në selinë e organizatorit dhe në pikat e shitjes të organizatorit.

Neni 33

Gjatë pagesës së fitimeve lojtari (fituesi) është i obliguar të dorëzojë vërtetimin mbi pagesën. Përveç dorëzimit të vërtetimit fituesi është i obliguar të tregojë dokumentin personal nëse i kërkohet nga personi i cili e bënë pagesën e fitimit.

Afati i pagesës së fitimeve

Neni 34

Pagesa e fitimeve të llojit të parë SuperBingo bëhet në afat prej 60 ditësh nga dita e tërheqjes publike.

Pagesa e fitimeve vjetërsohet në afat prej 60 ditëve nga dita e publikimit të raportit përfundimtar për rezultatet e lojës.

Tatimi në fitim

Neni 35

Në fitimet nga loja e fatit Bingo 15 nga 90 fituesit paguajnë tatimin në fitim në përputhje me ligjin për tatimet që është në fuqi.

Fitimet e pa paguara

Neni 36

Pas skadimit të afatit sipas nenit 34 të këtyre Rregullave, shërbimi kompetent konstaton se cilat fitime për xhiro nuk janë paguar dhe cila është vlera e tyre, dhe për këtë përpilon proces verbal.

Shuma e fitimeve të pa paguara në të holla do të bartet në ndonjë xhiro të ardhshme të lojës Bingo, ose do të shfrytëzohet për fitimet në lojërat tjera.

XIII. Mënyra e njoftimit të pjesëmarrësve me rregullat e lojës

Neni 37

Këto Rregulla do të shpallen në faqen zyrtare të organizatorit.

Neni 38

Këto Rregulla gjenden në të gjitha pikat e shitjes të organizatorit. Personave të interesuar për pjesëmarrje në lojën e fatit Bingo, organizatori është i obliguar të ju mundësoj njohjen me këto Rregulla gjegjësisht të njëjtat të ju jepen në shikim.

XIV. Procedura në rastin e revokimit - shtyrjes së tërheqjes

Neni 39

Organizatori mundet për shkaqe të arsyeshme të ndryshoj vendin, datën dhe kohën e tërheqjes, dhe për këtë organizatori e njofton opinionin përmes mjeteve të informimit. Organizatori po ashtu mund të revokojë organizimin e lojës me pëlqimin e ATK-së, në pajtim me nenin 14. të ligjit për lojërat e fatit.

Dispozitat kaluese dhe përfundimtare

Neni 40

Organizatori është i obliguar ti ruaj shënimet e vërtetimeve në CD së paku një vit duke llogaritur nga dita e mbajtjes së tërheqjes për xhiron e caktuar.

Në rastin kur është hapur kontesti gjyqësor për realizimin e të drejtës mbi fitimin në lojën Bingo, organizatori është i obliguar ti ruaj shënimet e vërtetimeve për atë rast deri në përfundimin e kontestit gjyqësor.

Neni 41

Kontestet që dalin nga pjesëmarrja në lojën Bingo i zgjedh Gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 42

Këto Rregulla hynë në fuqi ditën e publikimit dhe aplikohen nga 01.12.2016, në pajtim me ligjin mbi lojërat e fatit Nr. 04/L-080.

Nr. 358
01.12.2016.

Lotaria e Kosovës
Bashkim Sllamniku, Drejtor